



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PUKË**  
**KËSHILLI I BASHKISE**  
**KRYESIA**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Puke , me 08 .08.2024

**Procesverbal**

**i mbledhjes se kryesise se keshillit , i mbajtur sot me date 08.08.2024 :**

**Te njoftuar per mbledhje :**

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Alfons Gjergj
6. Hazbi Terbuni

Moren pjese:

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Alfons Gjergj
5. Hazbi Terbuni

Nuk mori pjese Besar Kuçi , per aresye shendetesore.

Tematika e mbledhjes eshte : Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak” per muajin Gusht 2024.

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka, I cili prezantoi projekt-rendin e dites te pergatitur paraprakisht ne bashkepunim me kryetarin e Bashkise dhe administraten e bashkise si me poshte vijon:

1. Miratimi i procesverbalit te mbledhjes së dates 10.07.2024
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Qershor 2024**.
3. Projekt - vendim “ Per miratimin e rishperndarjes se fondit te zerave nga shpenzime korente tek shpenzime per investime brenda te njejtit program per vitin 2024”
4. Projekt-vendim “Per nje shtese ne VKB nr.29 date 29.12.2023 “ Per miratimin e buxhetit te vitit 2024” dhe programit buxhetor afatmesem 2024-2026 ( i ndryshuar)
5. Projekt- vendim për dhënien në përdorim nga fondi pyjor për sheshe depozitimi të përkohshem të materialeve të ndryshme me sipërfaqe 0.2 ha në parcele 28/A në ekonomine pyjore Munell.

**6. Të tjera.**

Pas diskutimit të anetareve kryesia vendosi të miratojë të gjitha pikat e projekt- rendit të ditës , duke shtuar një pikë pas pikës 5, në rendin e ditës me këtë përmbajtje:

**“Vleresime me tituj nderi: 1. Prof. Dr. Eqrem Musli Zenelaj ( Paris Memaj nga Dardania) 2. I ndjeri Gjon Gjoni ( Shuku) ( pas vdekjes) 3. Z. Lulzim Cina “**

Perfundimisht kryesia vendosi të marrë : Vendimin nr.2 date 08.08.2024, ku u përcaktua data dhe ora e zhvillimit të mbledhjes së keshillit, data dhe ora e mbledhjes së komisioneve të përherëshme të keshillit detyrat për sekretarin e keshillit për bërjen publike të njoftimit dhe dërgimin e materialeve të përgatitura për mbledhjen e keshillit , sipas rendit të ditës së miratuar nga kryesia si më poshtë:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.07.2024
  2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Qershor 2024.**
  3. Projekt - vendim “ Per miratimin e rishpërndarjes së fondit të zerave nga shpenzime korentë tek shpenzime për investime brenda të njëjtit program për vitin 2024”
  4. Projekt-vendim “Per një shtesë në VKB nr.29 date 29.12.2023 “ Per miratimin e buxhetit të vitit 2024” dhe programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 ( i ndryshuar)
  5. Projekt- vendim për dhënien në përdorim nga fondi pyjor për sheshe depozitimi të përkohshëm të materialeve të ndryshme me sipërfaqe 0.2 ha në parcele 28/A në ekonomine pyjore Munell.
  6. Vleresime me tituj nderi: 1. Prof. Dr. Eqrem Musli Zenelaj ( Paris Memaj nga Dardania) 2. I ndjeri Gjon Gjoni ( Shuku) ( pas vdekjes) 3. Z. Lulzim Cina
- 7. Të tjera.**

**Shënim: Mbledhja e komisioneve të përherëshme të keshillit zhvillohet më datë 15 .08.2024 , në orën 14-<sup>00</sup> në zyrën e sekretarit të këshillit.**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Gjon Gjoka**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KËSHILLI BASHKIAK  
KRYESIA**

**VENDIM**

**Nr. 2 datë 08 .08 .2024**

**“PËR  
MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES SË RADHËS SË KËSHILLIT BASHKIAK”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr.14 datë 30/06/2020, neni 57, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 08. 08. 2024;

**Vendosi:**

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 16 . 08. 2024, ora 9.<sup>00</sup>.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit të rendit të ditës, si dhe dosjen me materialet e mbledhjes tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Të pranishëm ne mbledhje:

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Alfons Gjergji
5. Hazbi Terbuni

**Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Gjon Gjoka**